


Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë, 14.02.2022

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, duke marrë parasysh nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, bazuar në shtojcën 15 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, si dhe Planin e Punës të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin 2022, nxjerrë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzuesi i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për realizimin e Programit për Zhvillim Rajonal (kategoria e investimeve kapitale) për vitin 2022.
2. Obligohen të gjitha njësitë administrative të MZHR-së për zbatimin e dokumentit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Në rast të mospërputhjes së këtij udhëzuesi me legjislacionin e zbatueshëm, mbizotërojnë dispozitat ligjore në fuqi.
4. Këtij vendimi i bashkangjitet Udhëzuesi për realizimin e Programit për Zhvillim Rajonal për vitin 2022 dhe gjitha shtojcat e tij.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Besim Kamberaj

Zv. Sekretar i përgjithshëm

Vendimi i'u dërgohet;

- Ministrit të MZHR-së
- Udhëheqësve të njësive organizative në MZHR;
- Arkivit të MZHR-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

UDHËZUES PËR APLIKANTË

PROGRAMI PËR ZHVILLIM RAJONAL 2022 (INVESTIME KAPITALE)

PRISHTINË

Shkurt, 2022

UDHËZUESI PËR APLIKANTË, NGA PROGRAMI PËR ZHVILLIM RAJONAL 2022

HYRJE

Programi për Zhvillimi Rajonal ka për qëllim të kontribuojë në krijimin e kushteve për zhvillimin e ekonomik rajonal të qëndrueshëm në të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës dhe për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik, mjedisor dhe kulturor të balancuar. Shuma e këtij programi për vitin 2022 do të jete rreth 2,000,000.00 euro.

Objektivi i përgjithshëm

Programi për Zhvillim Rajonal me shumën e përafërt prej 2,000,000.00 € për vitin 2022,

1,760,000.00 euro janë në dispozicion për Programin për Zhvillim rajonal

240,000.00 euro janë në dispozicion për programin në bashkëpunim me CARITAS-in.

MZHR lanson këtë program me qëllim të përkrahjes së infrastrukturës për zhvillim socio-ekonomik në të gjitha Rajonet Zhvillimore. Ky program përfshinë edhe projektet të cilat nuk kanë mundur të finalizohen në v.2021 dhe për të cilat komunat përfituese dërgojnë arsyeshmëri të majtueshme MZHR mund ti merr në konideratë.

Rezultatet Specifike

Krijimi i këtij Programi do t'i mundësoj komunave për të zhvilluar më tej rolin e tyre udhëheqës në përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik përmes projekteve që kontribuojnë në një apo më shumë prioritete të listuara në Strategjinë e tyre për Zhvillimit Rajonal/lokal.

Llojet e aktiviteteve

Projektet do të kategorizohen si investime kapitale, të ndërlidhura me objektivin e përgjithshëm të Programit.

Vlera e projekteve qe aplikojnë komunat

MZHR për këtë program ka dy kategori të aplikimit dhe ate:

1. Kategoria e parë i dedikohet Projekteve të infrastrukturës publike për zhvillim socio-ekonomik rajonal dhe Projekteve për zonat ekonomike sipas kërkesave të komunave në kuadër të thirrjes për propozime të lansuar nga MZHR.

Shumat e kërkuara duhet të jenë në vlerë prej 50,000.00€ deri në 500,000.00€ për financim nga MZHR; (përrjashtimisht kur MZHR vlerson se Projekt Propozimi ka premisa që përmbushin kriteret dhe përputhet me mandatin e MZHR-së atëher Projekt Propozimi mund të tejkaloj këto vlera por që financimi dhe implementimi i ti do të vazhdoj për dy ose tri vite).

2. Kategoria e dytë i dedikohet kërkesave individuale të komunave gjatë gjithë vitit të cilat vlerësohen si kërkesa jashtë thirrjes për propozime.

Shumat e pranueshme janë nga 30,000.00 € deri në 80,000.00 € për financim nga MZHR.

Të gjitha shpenzimet e propozuara të buxhetit duhet të jenë të pranueshme sipas LMFP (Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë) të Kosovës dhe Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës (LPPK) që duhet të zbatohet gjatë gjithë kohës. Projektet Softërike zhvillohen drejtëpërdrejt nga MZHR.

Kriteret e Pranueshme

Vetëm komunat janë të lejueshme të aplikojnë për Programin për zhvillim rajonal. Aplikantët tjerë potencial si Këshillat e komuniteteve, OJQ, Asociacionet e ndryshme etj, duhet t'i adresojnë kërkesat e tyre përmes komunës.

1. Komuna duhet të propozoj projektin që është në pajtuesmëri me objektivin e përgjithshëm të Programin për zhvillim rajonal;
2. Një projekt ideor, dhe vlerësimi paraprak i kostos duhet të përgatitet nga komunat. Projektet ideore duhet të jenë në pajtuesmëri me normat ekzistuese dhe standardet e aplikueshme në Kosovë;
3. Projekti ideor duhet të hartohet në harmoni me standardet e vlerësimit të ndikimit në mjedis (aty ku është e aplikueshme) të aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor.
4. Projektet duhet të jenë projekte të reja dhe jo vazhdimësi e ndonjë projekti tjetër (Përjashtimisht në rastet kur projekti bartet nga viti paraprak i financuar nga MZHR dhe për të cilin komuna ofron arsyeshmëri të mjaftueshme);
5. Inkurajohen Komunat për aplikim me projekte të përbashkëta (dy e më shumë Komuna).
6. Minimumi i bashkëfinancimit nga Komunat për Projekte është 20% e vlerës së Kontratës së nënshkruar nga Komunat me OE (operatorin Ekonomik).
7. MZHR inkurajon dhe mirëpret gjetjen e Donatorëve nga Komunat për bashkëfinancim të Projekt Propozimeve të tyre në rastet kur shumat e projekteve tejkalojnë mundësitë buxhetore të MZHR-së dhe Komunës (Marrëveshje tripalëshe), sikur që Komunat janë të lira në gjetjen e Donatorëve për mbulimin e shumës prej 20% që Komuna merr si obligim për bashkëfinancim.
8. Projekti duhet të përfundojë brenda vitit 2022. (përjashtimisht Projekteve që me MeM parshihen si projekte që financimi dhe implementimi i tyre zgjatë më shumë se një vit).

SI TË APLIKONI;

Ky udhëzues dhe format për aplikim në kopje fizike janë në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, por të njëjtat publikohen në uebfaqen e MZHR-së.

Pyetjet në formularin e aplikimit duhet të plotësohen sa më shumë dhe sa më qartë që të jetë e mundur. Të gjitha pyetjet në formular janë të rëndësishme për aplikantët mirëpo kërkohet vëmendje e veçantë më sa vijon:

- Qëllimi i përgjithshëm dhe objektivat e projektit;
- Pse është i nevojshëm projekti;
- Cilat janë rezultatet e drejtpërdrejta të projektit;
- A mundet projekti të përfundoj me kohë dhe
- Qëndrueshmëria e projektit.

Nëse një komunë ka miratimin ose bashkëpunimin për projektet e tyre me ministritë përkatëse, të dhënat duhet t'i bashkëngjiten kërkesës. Një bashkëpunim i tillë është shpesh i nevojshëm për projektet lidhur me turizmin, bujqësinë, mjedisin dhe infrastrukturën tjetër komunale.

Formulari i aplikimit është në shtojcën (1) dhe duhet të plotësohet në mënyrë elektronike. Ai duhet të dorëzohet në MZHR deri më datë 11.03.2022 (Përgjashtimisht kërkesave individuale të komunave të cilat mund të dorëzohen gjatë gjithë vitit), në formën e printuar të kërkesës origjinale, të nënshkruar nga kryetari ose të skenuar dhe të dërguar përmes postës elektronike në email-in zyrtar të MZHR-së Shkrimorja.MZHR@rks-gov.net në rastet kur kemi aplikacione në partneritet me Komunitat tjera duhet plotësohet edhe Deklarata e Partneritetit siç është e përcaktuar shtojcën (2);

Për rastet e projekteve që nuk kanë përfunduar në v.2021 komunitat që kanë interesim të vazhdojnë ato projekte me MZHR duhet të dorëzojnë kërkesën me arsyeshmëri të mjaftueshme në mënyrë që MZHR ta shqyrtojë për financim.

Vlerësimi i projektit

Komisioni i vlerësimit do të jetë nga stafi i MZHR-së. Gjatë procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimit mund të kërkoj nga ministritë/komunitat përkatëse informata shtesë për një projekt propozim specifik.

Vetëm ato projekt-propozime që arrijnë një rezultat minimal prej 50% të pikëve do të kualifikohen. Nëse Programi vihet në dispozicion (p.sh nëpërmjet projekteve të miratuara mirëpo që kanë dështuar të pajtohen me Marrëveshjen e Mirëkuptimit), atëherë komisioni i vlerësimit do të rekomandon projektin e radhës për miratim nga lista rezervë.

Projektet e bartura vazhdojnë vetëm me Aneks marrëveshje të Mirëkuptimit pas rekomandimit të komisionit vlerësues.

Projektet e bartura (nga viti 2021) vazhdojnë vetëm nëse Komunitat përkatëse parashtrajnë kërkesa, kërkesa këto të cilat do të trajtohet nga Komisioni vlersues dhe

vetëm nëse Komisioni vlersues rekomandon vazhdimin e Projektit atëherë kjo bëhet me Aneks marrëveshje të Mirëkuptimit.

Aplikacionet e suksesshme/ pa-suksesshme

Komunat me aplikime të suksesshme, do të jenë të informuara se projektet e tyre janë miratuar dhe do të ju ofrohen Marrëveshjet e Mirëkuptimit (MM) të cilat do të hartohen nga MZHR-ja. Pasi që të nënshkruhet MM në mes të palëve nënshkruese, MZHR apo komuna varësisht nga MM do të filloj me procedurat për implementimin e projekteve. Për projektet që nuk e kalojnë pragun e pikëve prej 50% MZHR nuk do të financon.

Kushtet e pranueshmërisë

Ky fond do të jetë i hapur për aplikime nga komunat. Çdo komunë mund të paraqes aplikacionet sipas kategorive të përcaktuara. Aplikacionet duhet të ndjekin kriteret e përcaktuara në paketën e aplikimit dhe duhet të jenë brenda kompetencave vetanake të komunave siç përcaktohet në Nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë.

Kostot e pranueshme

Kosto e pranueshëm e projektit duhet të përfshijë kosto esenciale për sigurimin e realizimit të suksesshëm të projektit.

Kostot e papranueshme

Të gjitha shpenzimet për zhvillimin dhe menaxhimin e projektit sa i përket burimeve njerëzore nuk do të kompensohen për realizimin e projektit.

Roli i Agjensioneve për Zhvillim Rajonal

Komunat mund të ftojnë AZHR-të ku ato bëjnë pjesë, për të ndihmuar zhvillimin dhe përgatitjen e projekteve të pranueshme në bazë të strategjive lokale dhe rajonale për zhvillim ekonomik.

AZHR mund të ndihmojnë komunat në hartimin e projekt propozimeve.

Procedura e implementimit

Zhvillimi dhe miratimi i marrëveshje të mirëkuptimit (MiM). Komunat të cilat i dorëzojnë aplikacionet e suksesshme, do të informohen nga MZHR-ja sa më shpejt të jetë e mundur pas përfundimit të procesit të vlerësimit. MiM do të përgatiten nga MZHR-ja dhe do të diskutohen me komunat. Pasi të jenë pajtuar të dy palët mund të nënshkruhen MiM.

Procedurat e prokurimit

- Bartëse e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e Operatorit është MZHR përveq nëse ndryshe përcaktohet me marrëveshje të mirëkuptimit.
- Në rastet kur komunat do të zhvillojnë procedurat e prokurimit MZHR merrë pjesë me 1 (një) anëtar në hapje të ofertave, në proces të vlerësimit, në trajtim të kërkesave për rishqyrtim dhe në ri-vlerësim nëse ka një vendim për rishqyrtim.
- Procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në harmoni të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë (LPP).

Monitorimi dhe Raportimi

- MZHR-ja do të monitoroj projektet në secilen fazë të punimve.
- Një zyrtar nga MZHR caktohet përgjegjës për bashkëpunim në mes të Menaxherit dhe Organit mbikqyrës të caktuar me vendim nga Kryetari i Komunës përfituese pas nënshkrimit të Kontratës në mes Komunës përfituese dhe OE,
- Një zyrtar i MZHR-së do të monitoroj projektin gjatë gjithë fazave të implementimit, gjithsesi MZHR mund të angazhoj kompani mbikëqyrëse për të monitoruar pjesën e financimit të projektit.
- Komunat obligohen të raportojnë mbi progresin e projektit për MZHR-në si dhe një raport final në fund të projektit.
- Komunat pas dorzimit të raportit narativ të impementimit të Projektit duhet fillojnë proceduarat e pranimit teknik.
- Pas pranimit teknik Komunat kompletojnë dokumentacionin dhe të njëjtin e përcjellin tek zyrtari përgjegjës i MZHR-së për evidentim dhe regjistrim të pasurisë.
- Zyrtari përgjegjës i MZHR-së për evidentimin dhe regjistrimin e pasurisë me rastin e kompletimit të dokumentacionit përmes procedurave në afatin sa më optimal të njëjtin Projekt e bartë në pasuri të Komunës përfituese.

Pagesat e vazhdueshme për operatorët ekonomik të kontraktuar

Operatorët ekonomik do të përgatitin dhe paraqesin faturat e tyre në MZHR/Komuna, me të cilët ata kanë kontratë. Ata duhet të dorzojnë kërkesën për pagesë dhe pasi të vërtetohet se të gjitha procedurat e rregullta janë përfillur, do t'i bëhet pagesën bazuar në Ligjin e menaxhimit të financave publike në Kosovë. MZHR/Kompania mbikëqyrëse do të verifikon të gjitha pozicionet - punimet e kryera në teren para se të bëhet pagesa. Fatura përfundimtare duhet të dorëzohet me raportin përfundimtar, me së largu më 16.12.2022.

Drafti i Orarit Indikativ

AFATI (ORARI) PËR PROGRAMIN PER ZHVILLIM RAJONAL;

Data/afatet dhe Muaji	Aktiviteti
14 Shkurt 2022	Lansimi i Thirrjes së MZHR-së për Zhvillim Ekonomik Rajonal
21 - 25 Shkurt 2022	Sesionet Informuese për të gjitha Rajonet Zhvillimore
11 Mars 2022	Afati i fundit për dorëzimin e Projekteve nga Komunitat në MZHR (Përjashtësisht kërkesave individuale të komunave që pranohen vazhdimisht)
23 Mars 2022	MZHR-ja kryen vlerësimin e projekteve. MZHR-ja merr vendim për kërkesat e suksesshme dhe fillon me përgatitjen e Marrëveshjet të Mirëkuptimit
23-31 Mars 2022	Marrëveshjet e Mirëkuptimit nënshkruhen nga palët e përcaktuara në MiM
Prill/Maj 2022	Përgatitja e PIP dhe Miratimi i projekteve në Qeveri Zotimi i fondeve sipas projekteve
Prill / Maj - 2022	Përgatitja e dokumentacionit dhe shpallja e tenderit Fillojnë procedurat e prokurimit sipas MiM
Maj/Korrik 2022	Vlerësimi i tenderëve dhe përgatitja e kontratave, Fillimi i punimeve,
Qershor / Dhjetor 2022	MZHR-ja monitoron dhe kontrollon implementimin e projektit. Raportet e progresit nga komunitat ose MZHR përcaktohen me MiM
Qershor/Dhjetor 2022	Pranimi i lendeve për pagesë nga komunitat, Afati i fundit pranimit të lëndëve për pagesë nga komunitat 16.12.2022
Janar 2023	Raporti final



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Shtojca (1)

Aplikacioni i MZHR-së i Programit për Zhvillimin Rajonal 2022

Formulari për Aplikim

I. APLIKUESI

Komuna Aplikuese:

Rajoni Zhvillimor (.....):

Zyrtarët përgjegjës kontaktues të Komunës:

Kryetari:

Emri:

Telefoni:

Adresa:

e-mail adresa:

Personi përgjigjes për këtë projekt

Emri:

Pozita:

Departamenti:

Telefoni:

Adresa:

e-mail adresa:

II. Projekti

Titulli I Projektit:

Kostoja maksimale e projektit euro

Financimi nga Komuna: euro

Finacimi i kërkuar nga MZHR: euro

Koha e implementimit të projektit: prej..... Deri.....2022

Cilat Prioritete nga Strategjia juaj për Zhvillimi Rajonal/lokal i adreson ky projekt?

Një përshkrim i shkurt i projektit (dy-tre paragrafë)

Informatat e Projektit

Vendi (et) e Projektit:

	Pyetje	Po	JO
i	Komuna aplikuese a ka qenë përfituese në thirrjen për Programin për Zhvillim rajonal të viteve 2020 dhe 2021. Nëse "po", cilët(at) Projekte?		
ii	Projekt Propozimi a ndikon në rritjen e kapaciteve të zhvillimit ekonomik? Nëse "po", si do ta arrijë këtë:		
iii	A ka komuna një plan të qartë të qëndrueshmërisë dhe mirëmbajtjes së Projektit pas përfundimit: Kush do të menaxhojë aktivitetet/infrastrukturore pasi që projekti të përfundojë? Si do të mirëmbahen aktivitetet/infrastrukturore?		

Pyetjet kyçe rreth projektit

	Pyetjet	Përshkrimi
1	Qëllimet e përgjithshëm dhe Objektivat e projektit	
2	Pse Komuna/Komuniteti ka nevojë për këtë projekt?	
3	<p>a) Projekti pas përfundimit a e mbështetë strategjinë për zhvillim socio-ekonomik?</p> <p>b) Projekti pas përfundimit a e mbështete strategjitë nacionale apo sektoriale?</p>	
4	Cilët është impakti direkt nga ky projekt?	
5	Përshkruani dikimin afat'gjatë të këtij projekti?	
6	Kush janë partneret kyç në këtë projekte dhe si do të përfshihen ata?	
7	<p>a) Sa kontraktues prisni që ta përmbushin këtë projekt?</p> <p>b) Çfarë aktivitete kontraktori (ët) do të bëjë?</p> <p>c) Kohëzgjatja e implementimit të këtij Projekti?</p> <p>d) Ju lutem komplettoni tabelën me poshtë</p>	
8	Numro veçantitë dhe specifikat inovative apo origjinale rreth këtij projekti?	
9	A ndërlidhet ky projekte me projektet tjera të planifikuara, apo me ato që janë duke u zhvilluar apo ato të përfunduara në rrethin, nëse po si:	
10	Përshkruani se si projekti do të promovohet tek rrethi dhe komuniteti.	

Vlerësimi i rrezikut për këtë projekt

Rreziku	Probabiliteti (cilat janë gjasat që gjatë procedurave të ndodhë ndonjë problemi) - Te larta, - Të mesme, - Të vogla,	Impakti (nëse ndodhë ndonjë komplikim sa serioz mund të jet) - Te larta, - Të mesme, - Të vogla,	Personi përgjegjës për menaxhimin e projektit

ORARI I AKTIVITETEVE TE PROJEKTIT

Nr.	Aktet/Nen aktet	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Grup. implikuar
1	Prokurimi									
2	Punët									
3	Logjistika									
4	Ngritja e kapaciteteve për veprim									
5	Dukshmëria/veprimet promovuese									
6	Dorëzimin e rezultateve te projektit									
...	Aktivitete te tjera ...ju lutem specifikoni									

Llojet e Projekteve

	A është ky projekti në përgjithësi?	% nga buxheti total	Kosto e Parashikuar
a	Investimet kapitale: p.sh, zhvillimi infrastrukturor		
b	Investime jo-kapitale: në zonat ku janë të koncentruara Bizneset		

Vlera kryesore e këtij projekti (ju lutem bashkëngjitni një buxhet me te detajuar si aneks me formularin për aplikim

Dokumentet në vijim duhet të bashkëngjiten:

1. Dokumentacioni pronësor juridik (kopja e planit dhe fleta poseduese);
2. Projekti ideor me paramasë dhe parallogari;
3. Pëlqimet e nevojshme nga ministritë përkatëse (Nëse projekti kërkon pëlqime të tilla);
4. Konfirmimi i komunës për qëndrueshmëri të projektit.

Përkushtimi i Komunave

Ne garantojmë përkushtimin e komunës dhe stafit të komunës ndaj projektit.

Ne po ashtu garantojmë se komuna do të përmbush të gjitha obligimet e veta sipas Udhëzuesit dhe dokumentacionit përcjellës.

Nga Komuna:

Kryetari:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Shtojca (2)

Aplikacioni i MZHR-së i Programit për Zhvillimin Rajonal 2022

Formulari për Aplikim

I. APLIKUESI DHE PARTNERI(ET) E TIJ

Komuna/t Aplikuese:

Rajoni Zhvillimor (.....):

Zyrtarët përgjegjës kontaktues të Komunës:

Kryetari:

Emri:

Telefoni:

Adresa:

e-mail adresa:

Personi përgjegjes për këtë projekt

Emri:

Pozita:

Departamenti:

Telefoni:

Adresa:

e-mail adresa:

II. Komuna/t Partnere:

Rajoni Zhvillimor (.....):

Detajet e kontaktit për Komunën (at) Partnere:

Kryetari:

Emri

Telefoni:

Adresa:

e-mail Adresa:

Personi përgjegjës për këtë projekt

Emri:

Pozita:

Departamenti:

Telefoni:

Adresa:

e-mail adresa:

Përshkimi I Partnerit (ëve)

Roli dhe përfshirja në përgatitjen e propozim projektit	
Roli dhe përfshirja ne implementimin e projektit	
Nr. i punëtoreve dhe nr. I punëtoreve te përcaktuar për këtë projekte	
Resurset tjera relevante të caktuar për këtë projekte	
Përvoja ne projekte te ngjashme	
Histori bashkëpunimi me aplikuesin (përvojë e më hershme)	

Deklarata (atë) për Partneritet

Unë e kam lexuar dhe pajtohem me përmbajtjen e projekte propozimin të dorëzuar nganë programin e MZHR-së për ZHR (Zhvillim Rajonal). Unë premtose të punojë në përmbushjen e principeve dhe praktikave të mira të partneritetit.

Emri	
Organizata	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data dhe Vendi	

III. Projekti

Titulli I Projektit:

Kostoja maksimale e projektit euro

Koha e implementimit të projektit: prej..... Deri.....2022

Cilat Prioritete nga Strategjia juaj për Zhvillimi Rajonal/lokal i adreson ky projekt?

Një përshkrim i shkurt i projektit (dy-tre paragrafë)

Informatat e Projektit

Vendi (et) e Projektit:

	Pyetje	Po	JO
i	A do te vazhdoje ky projekt pa këtë grant? Nëse "po ", pse jeni duke aplikuar për këtë grant?		
ii	A është Komuna aplikuese apo Partneri(ët) të përfshire në ndonjë aplikim tjetër për programin e ZHR të 2021 me Komunë tjetër. Nëse "po", cilët(at)?		
iii	Roli i Partnereve në implementimin e këtij projekti:		
iv	A do ti rrite ky projekte kapacitete në komunë në çështjet për zhvillim ekonomik?		

	Nëse "po", si do ta arrijë këtë?		
V	A ka komuna një plan të qartë të qëndrueshmërisë pasi që projekti të kryhet? Kush do të menaxhojë aktivitetet/infrastrukturore pasi që projekti të përfundojë? Si do të mirëmbahen aktivitetet/infrastrukturore?		

Pyetjet kyçe rreth projektit

	Pyetjet	Përshkrimi
1	Qëllimet e përgjithshme dhe Objektivat e projektit	
2	Pse ka nevojë për këtë projekt?	
3	a) Si projekti e mbështet strategjinë për zhvillim ekonomik? b) Si projekti mbështet strategjitë nacionale apo sektoriale?	
4	Cilët janë rezultatet direkte nga ky projekt?	
5	Cili është ndikimi afat gjatë i këtij projekti?	
6	Kush janë partneret kyç në këtë projekt dhe cila është përfshirja e tyre?	
7	a) Sa kontraktues prisni që ta përmbushin këtë projekt?	

	b) Çfarë aktivitete kontraktori (ët) do të bëjë?	d) Ju lutem kompletini tabelën me poshtë
	c) Cili është afati kohor për këtë punë?	
8	A ka diçka te veçanet inovative apo origjinale rreth këtij projekti?	
9	Si ndërlidhet ky projekte me projektet tjera te planifikuara, që janë duke u zhvilluar apo projekte te përfunduara ne rrethin?	
10	Ju lutem ofroni informata se si projekti do te promovohet	

Vlerësimi i rrezikut për këtë projekte

Rreziku	Probabiliteti (cilat janë gjasat e për ndodhjen e një problem) te larta, mesme	Impakti (nëse një problem ndodhe, sa serioz është) I madhe, mesëm, ose I vogël	Personi përgjegjës për menaxhimin e rrezikut

ORARI I AKTIVITETEVE TE PROJEKTIT

Nr.	Aktet/Nen aktet	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Grup. Implikuar
1	Prokurimi									
2	Punët									
3	Logjistika									
4	Ngritja e kapaciteteve për veprim									
5	Dukshmëria/veprimet promovuese									
6	Dorëzimin e									

	rezultateve te projektit									
...	Aktivite te tjera ...ju lutem specifikoni									

Llojet e Projekteve

	A është ky projekti ne përgjithësi?	% nga buxheti total	
a	Investimet kapitale: p.sh, zhvillimi infrastrukturore		
b	Investime në zona ku janë të koncentruara bizneset		

Vlera kryesore e këtij projekti (ju lutem bashkëngjitni një buxhet me te detajuar si aneks me formularin për aplikim.

Dokumentet në vijim duhet të bashkëngjiten:

1. Dokumentacioni pronësoro juridik (kopja e planit dhe fleta poseduese);
2. Projekti ideor me paramasë dhe parallogari;
3. Pëlqimet e nevojshme nga ministritë përkatëse (Nëse projekti kërkon pëlqime të tilla);
4. Konfirmimi i komunës për qëndrueshmëri te projektit.

Përkushtimi i Komunave

Ne garantojmë përkushtimin e komunës dhe stafit te komunës ndaj projektit. Ne po ashtu garantojmë se komuna do te përmbush të gjitha obligimet e veta sipas Udhëzuesit.

Nga Komuna

Kryetari i Komunës:
